

FONDI I PENSIONIT VULLNETAR
“SiCRED PENSIONS”

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013
(me opinionin e audituesit të pavarur bashkëngjitur)

PASQYRA PERMBLEDHESE

	Faqe
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E AKTIVEVE NETO	1
PASQYRA E FITIM HUMBJE DHE TE ARDHURAVE PERMBLEDHESE TE TJERA	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE AKTIVET NETO	3
PASQYRA E FLUKSEVE TE PARASE	4
SHENIMET SHPJEGUESE PER PASQYRAT FINANCIARE	5-17
SKEDULE SUPLEMENTARE	i-ii



KPMG Albania Sh.p.k
"Dëshmorët e Kombit" Blvd
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Telephone +355(4)2274 524
+355(4)2274 534
Telefax +355(4)2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raporti i audituesve të pavarur

Aksionerëve të
Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit SiCRED sh.a.

Tiranë, 28 mars 2014

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të Fondi i Pensionit Vullnetar "Sicred Pensions" ("Fondi"), të cilat përbëhen nga pasqyra aktiveve neto më 31 Dhjetor 2013, pasqyrat e fitim humbje dhe të ardhurave përmbledhëse të tjera, ndryshimeve në aktive neto dhe flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet, që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi ynë, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.


Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Fondit më 31 dhjetor 2013, të rezultatit të tij financiar dhe të flukseve të tij monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Çështje të tjera

Në vijim të kërkesave të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare të Shqipërisë, ne kemi lexuar Skedulet Suplementare bashkëlidhur për Pasqyrën e Strukturës së Investimeve dhe Pasqyrën e Ndryshimeve në Kuotat e Fondit ("Skedulet Suplementare"). Skedulet Suplementare të përgatitura nga drejtimi, nuk janë pjesë e pasqyrave financiare bashkëlidhur. Informacioni financiar historik, i paraqitur në Skedulet Suplementare të përgatitura nga drejtimi, është i qëndrueshëm, në të gjitha aspektet materiale me informacionin financiar vjetor, pasqyruar në pasqyrat financiare të Fondit më 31 dhjetor 2013, përgatitur në përputhje me legjislacionin kombëtar të kontabilitetit, të aplikueshëm për fondet e pensionit në Shqipëri. Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e Skeduleve Suplementare, në përputhje me rregulloren e AMF nr. 25 datë 23 Shkurt 2011 "Mbi Raportimin e Shoqërisë Administruese të Fondit të Pensionit të AMF".

Steven Nutley
Partner



KPMG Albania Sh.p.k.
"Dëshmorët e Kombit" Blvd.
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana,
Albania

Fondi i Pensionit Vullnetar “SiCRED Pensions” - “SiCRED Pensions”
Voluntary Pension Fund

Pasqyra e Aktiveve Neto

(te gjitha shumat ne Lek, pervecse kur specifikohet ndryshe)

	Shënime	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
AKTIVE			
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	9	1,510,800	2,278,514
Investime në letra me vlerë	10	56,771,165	32,668,856
TOTALI AKTIVIT		58,281,965	34,947,370
DETYRIME			
Detyrime ndaj shoqërisë administruese	11	144,094	79,514
TOTALI I DETYRIMEVE		144,094	79,514
VLERA NETO E AKTIVEVE		58,137,871	34,867,856
Gjendja e numrit të kuotave të fondit		51,836	33,052
AKTIVET NETO PËR KUOTË TË FONDIT TË PENSIONIT		1,122	1,055

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga drejtimi i Shoqërisë Administruese të Fondit të Pensionit SiCRED sh.a.më 28 Mars 2014 dhe janë firmosur nga:



Estela Koçi

Armira Çitozi

Administratore e Përgjithshme

Drejtoreshë Finance dhe Kontabiliteti



Shënimet shoqëruese nga faqja 5 deri në faqen 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Fondi i Pensionit Vullnetar “SiCRED Pensions” - “SiCRED Pensions” Voluntary Pension Fund

Pasqyra e Fitim Humbjeve dhe te Ardhurave Permbledhese te tjera

(te gjitha shumat ne Lek, pervecse kur specifikohet ndryshe)

	Shënime	2013	2012
Të ardhura nga interesa të investimeve	12	4,099,104	1,986,140
Të ardhura të tjera nga interesa	13	3,284	13,708
Te ardhura te tjera		29	-
		4,102,417	1,999,848
Tarifa për Shoqërinë Administruese		1,355,387	706,728
		1,355,387	706,728
Zhvlerësimi i premium (discount) i aktiveve me maturitet fiks		316	-
Fitimi neto nga investimet		2,747,346	1,293,120
Te ardhura permbledhese te tjera		-	-
Fitimi neto nga investimet		2,747,346	1,293,120

Shënimet shoqëruese nga faqja 5 deri në faqen 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Fondi i Pensionit Vullnetar “SiCRED Pensions” - “SiCRED Pensions” Voluntary Pension Fund

Pasqyra e Aktiveve Neto

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

Shënime	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Rritja në vlerën neto të aktiveve nga investimet	2,747,346	1,293,120
RRITJA E AKTIVEVE NETO NGA VEPRIMTARIA E FONDIT	2,747,346	1,293,120
Kontribute të hyra nga anëtarët e Fondit	22,087,676	13,798,940
Tërheqje për pagesa pensioni dhe tërheqje të parakohëshme	(1,565,007)	(1,327,878)
RRITJA NETO NË AKTIVET NETO NGA TRANSAKSIONET ME KUOTAT E ANËTARËVE	20,522,669	12,471,062
RRITJA TOTALE NË AKTIVET NETO	23,270,015	13,764,182
AKTIVET NETO		
Në fillim të periudhës	34,867,856	21,103,674
Në fund të periudhës	58,137,871	34,867,856
NUMRI I KUOTAVE TË PENSIONIT NË FILLIM TË PERIUDHËS	33,052	21,104
Kuota të pensionit të emetuara mbi bazën e hyrjeve të kontributeve	20,240	13,257
Kuota të pensionit të tërhequra për shkak të pagesave të përfitimeve të pensionit ose shlyerje të parakohëshme	(1,456)	(1,309)
NUMRI I KUOTAVE TË PENSIONIT NË FUND TË PERIUDHËS	51,836	33,052

Shënimet shoqëruese nga faqja 5 deri në faqen 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Fondi i Pensionit Vullnetar “SiCRED Pensions” - “SiCRED Pensions” Voluntary Pension Fund

Pasqyra e Flukseve te Parase

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

	2013	2012
Rrjedhja e parasë nga aktiviteti operacional		
Rritja e vlerës së aktiveve neto	2,747,346	1,293,120
Rregullime për :		
Ndryshime në të ardhura të përlogaritura nga investimi në letra me vlerë	(502,416)	85,249
<i>Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operative:</i>		
Hyrje nga contribute të anëtarëve	22,087,676	13,798,940
Tërheqje për pagesat e përfitimeve të pensionit ose tërheqje të parakohëshme	(1,565,007)	(1,327,877)
Ndryshim në detyrime ndaj shoqërisë administruese	64,580	(894,293)
Ndryshim në detyrime të tjera	-	(33,909)
Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet operacionale	<u>22,832,179</u>	<u>12,921,230</u>
Rrjedhja e parasë nga aktiviteti investues		
Blerje letra me vlerë	23,599,893	15,008,044
Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet investues	<u>23,599,893</u>	<u>15,008,044</u>
Ulja neto në mjete monetare dhe ekuivalente me to	<u>(767,714)</u>	<u>(2,086,814)</u>
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të periudhës	<u>2,278,514</u>	<u>4,365,328</u>
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të periudhës (Shënimi 9)	<u>1,510,800</u>	<u>2,278,514</u>

Shënimet shoqëruese nga faqja 5 deri në faqen 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Fondi i Pensionit Vullnetar “SiCRED Pensions” - “SiCRED Pensions” Voluntary Pension Fund

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare te mbyllura me 31 Dhjetor 2013

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

1. Informacione të përgjithshme

Mbështetur në Ligjin nr 10197 datë 12 Dhjetor 2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar” (“ligji i ri”) në 13 Dhjetor 2011, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (“AMF”) bazuar në Vendimin Nr. 173, miratoi “Fondi i Pensionit Vullnetar SiCRED Pensions” (“Fondi”) nën administrimin e “Shoqërisë Administruese të Fondit të Pensionit SiCRED sh.a” (“Shoqëria”). Ky miratim iu njoftua Shoqërisë me shkresë më 23 Dhjetor 2011.

Shoqëria aktualisht administron vetëm një fond pensioni vullnetar të quajtur Fondi i Pensionit Vullnetar “SiCRED Pensions”, i cili nuk është entitet ligjor dhe nuk ka personalitet juridik.

Me vendimin Nr. 91, datë 18 .07.2012 të Bordit të AMF u miratua Tirana Bank sh.a. për të vepruar si depozitar i Fondit.

Shoqëria dhe Depozitari janë të detyruara të mbajnë të ndara aktivet, veprimet dhe regjistrimet e veta, nga aktivet, veprimet, dhe regjistrimet e Fondit, për këtë arsye edhe raportimet për shoqërinë dhe Fondin paraqiten të ndara.

Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit SiCRED sh.a. ka implementuar sistemin elektronik për administrimin e fondeve të pensionit vullnetar, i cili mundëson plotësimin e kërkesave të ligjit si dhe Rregullores nr. 139, datë 26.09.2012 “Mbi frekuencën dhe mënyrën e llogaritjes së vlerës neto të asetëve dhe cmimit të kuotës”. Përlllogaritja e vlerës neto të asetëve të Fondit të Pensionit Vullnetar “SiCRED Pensions” kryhet automatikisht nga sistemi elektronik efektivisht nga data 01.01.2013 e në vazhdim. Gjithashtu, janë zhvilluar dhe instaluar në sistemin elektronik raportet rregullatore sipas Rregullores nr. 25, datë 23.02.2011 “Për raportimin në AMF të veprimtarisë së shoqërisë administruese të fondeve të pensionit”.

2. Bazat e përgatitjes

a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

b) Bazat e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

c) Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në monedhën shqiptare “Lek”, e cila është monedha funksionale. Përveç rasteve kur është shënuar ndryshe, informacioni financiar është paraqitur në Lek.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të vlerësuara. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Në veçanti, informacioni rreth fushave më kryesore për llogaritjen e pasigurisë dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare përshkruhet në shënimin 8.

Politikat kontabël të vendosura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare dhe janë aplikuar në mënyrë të qëndrueshme nga Fondi.

Fondi i Pensionit Vullnetar “SiCRED Pensions” - “SiCRED Pensions”

Voluntary Pension Fund

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare te mbyllura me 31 Dhjetor 2013

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

a) Plani i Kontributeve të Përcaktuara

Nën planin e kontributeve të përcaktuara shuma e përfitimeve të ardhshme është përcaktuar nga kontributet e paguara dhe nga interesat e fituara të fondit. Detyrimet janë njohur në fitim apo humbje në periudhën e duhur dhe janë paraqitur si interesa të shtuara të Fondit të pensionit nga të ardhurat nga investimet.

b) Instrumentat Financiarë

(i) Njohja

Fondi në fillim njihet huatë, parapagimet dhe detyrimet në datën e krijimit. Të gjithë aktivet e tjera financiare dhe detyrimet njihen së pari në datën e tregimit, datë në të cilën Fondi bëhet pjesë e palëve kontraktuale të instrumentit.

(ii) Klasifikimi

Shih politikat kontabël 3 (c),(d),(e) dhe (f).

(iii) Ç’regjistrimi

Fondi ç’regjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktiviteti financiar mbarojnë, ose kur i transferon aktivin një pale tjetër, pa mbajtur kontrollin, rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit. Çdo interes në aktivet e transferuara që është krijuar apo i mbahet Fondit është njohur si aktiv apo detyrim më vete i ndarë. Fondi ç’regjistron një detyrim financiar kur detyrimet e kontraktuara kanë mbaruar, janë shlyer, ose anuluar.

iv) Netimi

Aktivitetet financiare dhe detyrimet netohen midis tyre dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, vetëm dhe vetëm kur Fondi ka të drejtën ligjore të netojë këto shuma, t’i shlyejë këto shuma ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet janë paraqitur në baza neto vetëm kur lejohet nga standardet e kontabilitetit, ose për fitimet dhe humbjet e ndodhura nga një grup i ngjashëm transaksionesh si ato në aktivitetin tregues të Fondit.

(v) Matja me kosto të amortizuar

Kosto e amortizuar e një aktiviteti apo detyrimi financiar është vlera në të cilën një aktivitet apo detyrim financiar njihet në momentin fillestar, minus pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar llogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë midis shumës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus ndonjë zbritje për efekt zhvlerësimi.

(vi) Matja me vlerë të drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare është bazuar në çmimet e kuotuar të tregut ose në çmimet e agjentëve të shitjes në një treg aktiv. Për të gjithë instrumentet e tjera financiare vlera e drejtë është përcaktuar duke përdorur teknika vlerësimi. Metodatat e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e flukseve monetare të skontuara dhe krahasimin me instrumente të tjerë të ngjashëm për të cilat ekzistojnë çmime tregu dhe metoda vlerësimi.

Fondi i Pensionit Vullnetar “SiCRED Pensions” - “SiCRED Pensions”

Voluntary Pension Fund

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare te mbyllura me 31 Dhjetor 2013

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

b) Instrumentat financiarë (vazhdim)

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi, Shoqëria vlerëson nëse ka një evidencë objektive që aktivet financiare të Fondit janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen kur një evidencë objektive paraqet që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit dhe që ngjarja që sjell humbje ka ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri. Shoqëria konsideron provë të zhvlerësimit si për një aktiv specifik, ashtu edhe në bazë kolektive. Të gjithë aktivet financiare të konsiderueshme janë vlerësuar për zhvlerësim specifik. Të gjithë aktivet e konsiderueshme, për të cilat specifikisht nuk ka evidenca për zhvlerësim janë vlerësuar bashkë për ndonjë zhvlerësim që ka ndodhur, por nuk është identifikuar ende. Aktivet që nuk janë individualisht të konsiderueshme janë trajtuar kolektivisht për zhvlerësim duke grupuar bashkë aktivet financiare (mbajtur me kosto të amortizuar) me karakteristika të ngjashme risku. Një evidencë objektive që aktivet financiare janë zhvlerësuar mund të përfshijë mospagesat e një debitori, ristrukturimin e një huaje ose paradhënie nga Fondi në terma që Fondi nuk do ti konsideronte në tjetër rast, treguesë që një debitor hyn në falimentim apo të tjera të dhëna lidhur me një grup aktivesh si ndryshimet e pafavorshme në gjendjen e pagesës së kreditorëve, emetuesve në grup, ose në kushtet ekonomike që të çojnë në mospagime në grup.

c) Mjete monetare në arkë dhe bankë

Mjetet monetare në arkë dhe bankë përfshijnë gjendjet monetare në arkë, paratë e vendosura në banka dhe investime mjaft likuide afat-shkurtra me maturitet më pak ose deri në tre muaj nga momenti i blerjes.

d) Depozita me afat

Depozitat me afat janë vendosur në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën e principalit dhe janë klasifikuar si të tilla ato me maturitet më shumë se tre muaj. Interesi është përlllogaritur në baza rritëse dhe interesi i arkëtueshëm është pasqyruar në të arkëtueshme të tjera.

e) Letra me vlerë

Letrat me vlerë janë tituj borxhi të cilët Fondi ka qëllimin dhe mundësinë t'i mbajë deri në maturim dhe klasifikohen si aktive për tu mbajtur deri në maturim. Investimet, të cilat kanë pagesa fikse apo të përcaktuara dhe të cilat janë me qëllim për t'u mbajtur në maturim maten me kosto të amortizuar, minus parashikimi për zhvlerësim në vlerë. Kosto e amortizuar është përlllogaritur duke marrë në llogari ndonje zbritje apo prim ne blerje. Primi dhe zbritja e investimeve të mbajtura deri në maturim amortizohen në mënyrë sistematike deri në maturim duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe regjistrohen në të ardhura nga interesat.

f) Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme të tjera janë mbajtur me kosto të amortizuara.

g) Vlera neto e aktiveve të Fondit

Vlera neto e aktiveve të është e barabartë me totalin e aktiveve minus detyrimet e Fondit.

Fondi i Pensionit Vullnetar “SiCRED Pensions” - “SiCRED Pensions” Voluntary Pension Fund

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare te mbyllura me 31 Dhjetor 2013

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

h) Të ardhurat nga interesi në letra me vlerë

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat e investimeve njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në bazë të metodës së interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare përgjatë jetës së aktivitetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme për një periudhë më të shkurtër) në vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset në momentin fillestar të njohjes së aktivitetit, ose detyrimit financiar dhe nuk ndryshohet në periudhat e mëtejshme.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të marra, kostot e transaksionit, zbritjet apo primet të cilat janë pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit janë kosto shtesë të lidhura me blerjen, emetimin ose ç'rregjistrimin e aktivitetit, ose detyrimit financiar. Të ardhurat nga interesat e bonove të thesarit të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave pasqyrojnë interesin e aktiveve financiare të investuara të Fondit.

i) Tarifa e administrimit

Fondi detyrohet t'i paguajë Shoqërisë një tarifë prej 3% (në bazë vjetore) të Vlerës Neto të Aktiveve, shpenzim ky për Fondin i cili përlllogaritet në bazë ditore. Meqenëse në vitin e kaluar, ky shpenzim është përlllogaritur në bazë mujore, ndryshimi i mënyrës së përlllogaritjes nga tarifë mujore në tarifë ditore, diktuar nga hyrja në fuqi e Rregullores nr. 139, datë 26.09.2012 “Mbi frekuencën dhe mënyrën e llogaritjes së vlerës neto të asetëve dhe cmimit të kuotës”, rezulton si ndryshim në vlerësimet kontabël dhe është zbatuar me efekt prospektiv.

4. Standarde dhe interpretime të reja të cilat nuk janë adoptuar akoma

Një numër i ri standardesh të reja, ndryshimesh të standardeve dhe interpretimeve nuk janë bërë ende efektive për periudhën duke filluar nga 1 Janar 2013, dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Asnjë nga këto standarde nuk do të ketë efekt në këto pasqyra financiare. Asnjë nga këto nuk pritet të ketë një efekt material në pasqyrat financiare të Fondit përveç SNRF 9 Instrumentat Financiarë, që bëhen të detyrueshme për pasqyrat financiare të Fondit për vitin 2015 dhe mund të ndryshojnë klasifikimin dhe matjen e asetëve financiare. Fondi nuk ka në plan të adoptojë këtë standard më përpara dhe niveli i ndikimit nuk është përcaktuar.

5. Politika e investimeve të Fondit të Pensionit Vullnetar “SiCRED PENSIONS”

Politika e Investimeve (PI) përbën dokumentin kryesor që kontrollon strategjinë e investimeve të Fondit. PI së bashku me Politikën e Menaxhimit të Riskut (PMR) përbëjnë dy shtyllat kryesore të Komitetit të Investimit (KI) për të administruar dhe realizuar objektivat kryesore të fondit. Fondi do të menaxhohet në përputhje me ligjin Nr. 10197 datë 10 Dhjetor 2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar” dhe me të gjitha rregulloret e lidhura. Elementët kryesorë të PI janë:

- Përcaktimi i qartë dhe ndarja e përgjegjësive të të gjitha palëve të përfshira: Këshilli i Administrimit, Komiteti i Investimit, Pjesëmarrësit e Fondit (kontribuesit), dhe Depozitari;
- Përcaktimi i Objektivave dhe i kufizimeve të investimit;
- Përcaktimi i alokimit të asetëve të fondit;
- Vlerësimi i performancës së fondit në krahasim me “benchmark-un” e përcaktuar;
- Vendosja e procedurës së komunikimit midis Këshillit të Administrimit, Depozitarit, dhe Komitetit të Investimeve.

Fondi i Pensionit Vullnetar “SiCRED Pensions” - “SiCRED Pensions”

Voluntary Pension Fund

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare te mbyllura me 31 Dhjetor 2013

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

6. Kufiri i Investimeve të lejuara

Kufiri i investimeve të lejuara përcaktohet në rregulloren “Për aktivet e lejuara, kufizimet dhe kufirin maksimal të investimit të Fondit të pensionit”, miratuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare me vendimin e Bordit nr 1, datë 28 Janar 2010 dhe ndryshuar me vendimin e Bordit 109, datë 18 October 2010. Sipas rregullores, asetet e fondit nuk mund të investohen më shumë se:

- a) 100% në obligacione, bono thesari dhe letra të tjera me vlerë të emtuara ose të garantuara nga Republika e Shqipërisë;
- b) 20% në depozita bankare në të njëjtën bankë;
- c) 30% në letra borxhi të klasifikuara si BBB ose më lartë, sipas Standard & Poor’s ose Fitch, Baa3 ose më lartë sipas Moody’s, ose BBB (e ulët) ose më lartë sipas DBRS (Dominion Bond Rating Service), por jo më shumë se 10 %, në një emetues të vetëm;
- d) 30% në aksione ose në kuota të fondeve të investimit të licensuara në një shtet anëtar të BE-së dhe:
 - i. që asetet e tyre investohen në indekset në vijim: CAC 40, DAX, FTSE 100, S&P 500, Mesatarja Industriale e Dow Jones, Nikkei 225 (Japoneze), Sensex (Indiane), All Ordinaries (Australiane) dhe Indeksi Hang Seng (Hong Kong); ose
 - ii. që asetet e tyre investohen në obligacione, bono thesari dhe letra të tjera me vlerë të emtuara ose të garantuara nga shtetet anëtare të BE-së;
- e) 100% në obligacione, bono thesari ose në letra të tjera me vlerë të emtuara ose të garantuara nga Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane e Investimeve dhe Banka Botërore;
- f) 100% në obligacione, bono thesari dhe letra të tjera me vlerë të emtuara ose të garantuara nga shtetet anëtare të BE-së ose të OECD-se ose nga bankat qendrore përkatëse, por:
 - i jo më shumë se 30% në një emetues të vetëm.
 - ii kufiri rritet deri në 100% në një emetues të vetëm, pas miratimit nga AMF, sipas argumenteve të dhëna për një politikë të tillë investimi.

Alokimi Strategjik i Aseteve

Pjesa më e madhe e alokimit të asetëve i përket bonove të thesarit dhe obligacioneve të qeverisë Shqiptare si në tabelën më poshtë:

Klasa e asetëve	Minimumi	Maksimumi
Bono thesari dhe obligacione të emtuara dhe të garantuara nga Qeveria e RSH.	70%	100%
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	1 %	15%
Bono thesari dhe obligacione të shteteve anëtare të BE të denominuara në monedhën EUR	0%	30%
Depozita në banka të licensuara nga Banka e Shqipërisë	0%	20%

Politika Fiskale dhe ajo Monetare ndikojnë ndjeshëm në normat e interesit të bonove të thesarit. Si të tilla ato do të monitorohen vazhdimisht për të përcaktuar impaktin e tyre në asetet e fondit. Alokimi strategjik i asetëve do rishikohet nga Komiteti i Investimit një herë në vit. Rishikimi nuk nënkupton domosdoshmërisht ndryshim në politikën investuese.

Fondi i Pensionit Vullnetar “SiCRED Pensions” - “SiCRED Pensions”

Voluntary Pension Fund

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare te mbyllura me 31 Dhjetor 2013

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

7. Administrimi i riskut financiar

a) Të përgjithshme

Shoqëria gjatë aktivitetit të saj ekspozohet ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- b) Risku i kreditimit
- c) Risku i likuiditetit
- d) Risku i tregut
- e) Risku operacional

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj çdo risku të përmendur më lart, si dhe politikat dhe procedurat për administrimin e këtyre risqeve.

Kuadri i Administrimit të Riskut

Sipas ligjit nr.10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetare” Shoqëria Administruese duhet të ketë një funksion te veçantë për administrimin e riskut. Në strukturën e re organizative, Menaxheri i Riskut është përgjegjës për administrimin e riskut dhe raporton te Administratori i Përgjithshëm.

Politikat janë zhvilluar në bazë të strukturës së Fondit të Pensioneve dhe tolerancës së riskut të vendosur në politikën e investimeve. Skema e Fondit është e tillë që kontributet janë të përcaktuara, ndërsa përfitimet nuk janë të përcaktuara. Dallimi kryesor është që risku mbahet plotësisht nga klientët që kontribuojnë. Toleranca e riskut është elementi kryesor që përcakton diferencën midis fondeve nën administrim dhe që së bashku me me skemën e fondit qëndron në thelb të zhvillimit të politikës së menaxhimit të riskut.

Për të menaxhuar riskun financiar, Shoqëria ndërremerr një proces që përbëhet nga identifikimi i ekspozimeve, vendosja e limiteve të lejuara të këtyre ekspozimeve, matjen e vazhdueshme të ekspozimeve, monitorimin e limiteve, dhe axhustimin e ekspozimit brenda intervaleve të kërkuara. Shoqëria do të përdorë instrumentat derivativë në fazën e axhustimit vetëm për qëllime mbrojtjeje.

b) Risku i kreditit

Emetuesit e instrumentave financiare në portofol mund të dështojnë në pagesat e interesit ose të kryegjësë. Rënia e cilësisë së kreditit mund të vijë nga rënia në vlerë dhe likuiditet të instrumentave të tregut. Një rritje në shtrirjen e kredisë mund të ulë vlerën e tregut të instrumentave duke sjellë një rënie të përgjithshme në vlerën neto të aktiveve të Fondit.

Alokimi strategjik i aseteve është në përputhje me rregulloren “ Për aktivet e lejuara, kufizimet dhe limiti maksimal i investimeve të fondeve të pensionit” datë 18 Tetor 2010 dhe përfshin vetëm instrumenta borxhi të emtuar nga Thesari i Qeverisë Shqiptare dhe Qeverive të BE. Instrumentat e borxhit sipas klasifikimit të kreditit janë si më poshtë:

	Instrumenta Borxhi	
	31-Dec-13	31-Dec-12
Pa vonesa dhe të pazhvlerësuara		
Afatshkurtra: klasifikimi B (Shqipëria)	56,771,165	32,668,856
Vlera kontabël	56,771,165	32,668,856

Fondi i Pensionit Vullnetar “SiCRED Pensions” - “SiCRED Pensions” Voluntary Pension Fund

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare te mbyllura me 31 Dhjetor 2013

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

7. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

c) Risku i likuiditetit

31 Dhjetor 2013	Vlera kontabël	Flukset monetare kontraktuale	Më pak se 1 muaj	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	6 muaj - 1vit	1 - 10 vjet
Aktivet monetare							
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	1,510,800	1,510,800	1,510,800	-	-	-	-
Investime në letra me vlere	56,771,165	80,206,696	166,420	1,170,206	1,205,488	5,542,114	72,122,469
	58,281,965	81,717,496	1,677,220	1,170,206	1,205,488	5,542,114	72,122,469
Detyrimet monetare							
Detyrime ndaj Shoqërisë Administruese	144,094	144,094	144,094	-	-	-	-
	144,094	144,094	144,094	-	-	-	-
Pozicioni neto	58,137,871	81,573,402	1,533,126	1,170,206	1,205,488	5,542,114	72,122,469
Efekti akumuluar			1,533,126	2,703,332	3,908,820	9,450,933	81,573,402

Fondi i Pensionit Vullnetar “SiCRED Pensions” - “SiCRED Pensions” Voluntary Pension Fund

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare te mbyllura me 31 Dhjetor 2013

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

7. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

c) Risku i likuiditetit (vazhdim)

31 Dhjetor 2012	Vlera kontabël	Flukset monetare kontraktuale	Më pak se 1 muaj	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	6 muaj -1vit	1 - 5 vjet
Aktivët monetare							
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	238,150	238,150	238,150	-	-	-	-
Depozita me afat	2,040,364	2,040,364	2,040,364	-	-	-	-
Investime në letra me vlere	32,668,856	49,400,435	-	808,000	775,255	1,583,255	46,233,925
	34,947,370	51,678,949	2,278,514	808,000	775,255	1,583,255	46,233,925
Detyrimet monetare							
Detyrime ndaj Shoqërisë Administruese	79,514	79,514	79,514	-	-	-	-
	79,514	79,514	79,514	-	-	-	-
Pozicioni neto	34,867,856	51,599,435	2,199,000	808,000	775,255	1,583,255	46,233,925
Efekti akumuluar			2,199,000	3,007,000	3,782,255	5,365,510	51,599,435

Fondi i Pensionit Vullnetar “SiCRED Pensions” - “SiCRED Pensions” Voluntary Pension Fund

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare te mbyllura me 31 Dhjetor 2013

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

7. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

(d) Risku i tregut

Risku i tregut përbëhet nga risku i normave të interesit. Fondi nuk është i ekspozuar ndaj ndonjë risku të kurseve të këmbimit.

Ekspozimi ndaj riskut të normave të interesit

Norma e interesit dhe çmimi i obligacioneve janë të lidhen në mënyrë të anasjelltë. Nga ana tjetër një ambient me norma të ulëta interesi përbën një sfidë për të siguruar një normë kthimi të brendshëm të përshtatshme.

Tabela më poshtë paraqet ndikimin në të ardhurat neto nga interesi në Lek si pasojë e një ndryshimi të kurbës së interesit me 100pb për portofolin e titujve me të ardhura fikse:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Skenari	(Humbje)/Fitim	(Humbje)/Fitim
mbi 100pb	(1,952,937)	(1,227,335)
nën100bp	1,952,937	1,227,335

Risku operacional

Risku operacional përbën riskun e humbjeve nga mos-funksionimi i sistemeve dhe i procedurave të brendshme. Shoqëria ka përpiluar procedura të brendshme dhe sisteme kontrolli për monitorimin e riskut operacional të Fondit.

Procedurat e brendshme e kanë lehtësuar aktivitetin normal operacional të biznesit. Risqet e tjera që lidhen me reputacionin dhe çështje ligjore janë adresuar nga shoqëria mëmë, SiCRED Shoqëri Sigurimi Jete, e cila ka eksperiencë në menaxhimin e këtyre risqeve.

Individët përballen me tre risqe të rëndësishme kur mendojnë për zgjedhjen e kursimeve dhe investimeve për pension:

- (1) risku i tregut financiar,
- (2) risku i jetëgjatësisë,
- (3) risku i moskursimit të duhur apo i shpenzimeve të tepërta që sjellin mosplotësimin e nevojave për të ardhura gjatë fazës së pensionit. Pjesë e riskut të tretë është dhe risku nga inflacioni.

Risku i Tregut Financiar

Risku i tregjeve financiare apo luhatshmëria e tregjeve të kapitalit mund të shkaktojë fluktuacion të vlerës së portofolit në afatshkurtër edhe pse në afatgjatë vlera e portofolit mund të rritet. Nëse tregu bie apo ndryshimet ndodhin në momentin që klienti kalon nga faza e akumulimit në atë të pensionit (faza e tërheqjes), atëherë portofoli i individit mund të mos i përballojë tërheqjet e ardhshme sistematike. Rrjedhimisht, portofoli mund të mos gjenerojë dot të ardhura të mjaftueshme për stilin e jetesës së dëshiruar të individit ose thjesht mund të përfundojnë flukset monetare përpara se individit të vdesë. Investuesit mund ta injorojnë riskun financiar duke supozuar një normë të qëndrueshme të kthimit nga portofoli i tyre i pensionit (p.sh luhateshmerite e tregut).

Menaxhimi i riskut financiar në shoqëri është një process që fillon me identifikimin e risqeve, vendosjen e limiteve të ekspozimit, matjen e vazhdueshme të ekspozimeve, monitorimin e limiteve, dhe përfundon me axhustimin e ekspozimit brenda niveleve të kërkuara. Shoqëria përdor instrumenta derivative në fazën e rregullimit vetëm për qëllime mbrojtje. Masat e rrezikut të tregut për rrezikun e normave të interesit është “modified duration”, e cila mat sensitivitetin e vlerës së tregut kundrejt ndryshimeve të normave të tregut.

Fondi i Pensionit Vullnetar “SiCRED Pensions” - “SiCRED Pensions”

Voluntary Pension Fund

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare te mbyllura me 31 Dhjetor 2013

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

7. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

(d) Risku i Tregut Financiar (vazhdim)

Risku i Jetegjatisë

Të jetuarit më gjatë nënkupton nevojën e zotërimit të më shumë burimeve për të përballuar kërkesat afatgjatë për shpenzim. Risku i jetëgjatësisë, është mundësia që vlera e portofolit (kursimet e akumuluar) të ketë një jetëgjatësi shumë më të vogël sesa jetëgjatësia e individit gjatë periudhës së pensionit. Investuesit janë të gatshëm të paguajnë një prim sigurimi për të shmangur këtë lloj risku. “Të përvitshmet” janë një produkt konvertojnë investimin e akumuluar në të ardhura (benefite) që i paguhen klientit gjatë gjithë jetës (periudhës së pensionit) së mbetur. Përfitimi përgjatë jetës sigurohet duke e shtrirë riskun e jetëgjatësisë mbi një numër të madh të përvitshmesh dhe duke bërë supozime të kujdesshme dhe konservative mbi normën kthimit që do të fitohet mbi asetet.

Kursimi i pamjaftueshëm

Investuesit mund të mos kursejnë aq sa për të financuar mjaftueshëm portofolet e pensionit. Skema me kontribute të përcaktuara kërkon mjaft këshillim financiar si përgjatë fazës së akumulimit ashtu edhe përgjatë fazës së tërheqjeve. Sfida që mbart me vete skema e kontributeve të përcaktuara nënkupton që klientët të zgjedhin alokimin e duhur të aseteve si dhe produkte që do të sigurojnë një pension të përshtatshëm përgjatë jetës. Shoqëria përpiqet të sigurojë këshillim financiar cilësor ndaj klientëve të saj.

8. Paraqitja me vlerë të drejtë

Çmuarja e vlerave të drejta bazohet në instrumentat financiarë ekzistues pa u përpjekur për të vlerësuar vlerën e biznesit të pritshëm dhe vlerën e aktiveve dhe pasiveve që nuk konsiderohen instrumenta financiarë.

Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre – Detyrimet nga llogaritë bankare ku përfshihen mjetet monetare në bankë dhe depozita me afat përmbajnë edhe vendosjet ndër-bankare dhe llogaritë e mbledhshme. Duke qënë se depozitat janë afatshkurtra dhe me interesa të luhatshëm vlera e tyre e drejtë konsiderohet e përafert me vlerën kontabël.

Letrat me vlerë - Investimet në obligacione thesari janë aktive që fitojnë interes dhe janë të mbajtura deri në maturim. Për shkak se nuk ekziston një treg aktiv për këto letra me vlerë, vlera e drejtë është vlerësuar duke përdorur një model të skontimit të rrjedhjeve të parasë bazuar në një kurbë të normës të kthimit aktuale të përshtatshme për afatin e mbetur deri në maturim.

	Te mbajtura deri ne maturim	Te vlefshme per shitje	Kredi dhe te arketuesh me	Kosto te tjera te amortizuara	Totali i vleres kontabel	Vlera e drejte
31 Dhjetor 2013						
Mjete monetare	-	-	-	1,510,800	1,510,800	1,510,800
Investime në bono	56,771,165	-	-	-	56,771,165	62,107,294
Detyrime	-	-	-	144,094	144,094	144,094
31 December 2012						
Mjete monetare	-	-	-	2,278,514	2,278,514	2,278,514
Investime në bono	32,668,856	-	-	-	32,668,856	33,243,373
Detyrime	-	-	-	79,514	79,514	79,514

Matja e vlerës së drejtë përfshirë në informacionin shpjegues të pasqyrave financiare për 31 Dhjetor 2013 është bazuar në Nivelin 2 të hierakisë.

Fondi i Pensionit Vullnetar “SiCRED Pensions” - “SiCRED Pensions” Voluntary Pension Fund

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare te mbyllura me 31 Dhjetor 2013

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

9. Mjete monetare dhe ekuivalentë me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to janë të përbërë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Llogari në banka në Lek	1,510,800	238,150
Depozita afatshkurtëra	-	2,040,000
Interesa të përlllogaritur	-	364
Total	1,510,800	2,278,514

Depozita me 31 Dhjetor 2012 perfaqeson depozite afatshkurter me Tirana Bank e cila maturohet me 7 Janar 2013 me nje norme interesi vjetore 1.5%.

10. Investime në letra me vlerë

Investimet në letra me vlerë përfaqësojnë investimet e Fondit në obligacione qeveritare përgjatë 2013 (2012: Obligacione qeveritare), si më poshtë:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Çmimi i blerjes	55,599,894	32,000,000
Interesa të përlllogaritur	1,171,271	668,856
Totali	56,771,165	32,668,856

Detaje të investimeve në letra me vlerë të Fondit më 31 Dhjetor 2013 paraqiten si më poshtë:

Datë emetimi	Date maturimi	Interesi nominal (%)	Interesi efektiv (%)	Emërtimi	Vlera Nominale	Çmimi i blerjes	Interesa të përlllogaritur	Vlera kontabël
20.08.2012	20.08.2014	8.4	8.58	ALTN2Y200814	1,400,000	1,400,000	42,549	1,442,549
20.12.2012	20.12.2014	7.68	7.84	ALTN2Y201214	1,600,000	1,600,000	3,523	1,603,523
21.03.2013	21.03.2015	7.22	7.35	ALTN2Y210315	2,000,000	2,000,000	40,240	2,040,240
05.07.2013	05.07.2016	7.78	7.92	ALTN3Y050716	2,300,000	2,300,000	87,634	2,387,634
05.10.2012	05.10.2015	8.84	9.03	ALTN3Y051015	2,000,000	2,000,000	41,719	2,041,719
07.01.2013	07.01.2016	8.55	8.73	ALTN3Y070116	1,800,000	1,800,000	73,938	1,873,938
08.04.2013	08.04.2016	8.18	8.34	ALTN3Y080416	1,400,000	1,400,000	26,158	1,426,158
07.05.2013	07.05.2018	8.45	8.62	ALTN5Y070518	1,400,000	1,400,000	17,695	1,417,695
08.02.2013	08.02.2018	8.89	9.08	ALTN5Y080218	1,800,000	1,800,000	62,540	1,862,540
08.11.2012	08.11.2017	9.17	9.37	ALTN5Y081117	2,400,000	2,400,000	31,611	2,431,611
09.02.2012	09.02.2017	9.50	9.71	ALTN5Y090217	8,000,000	8,000,000	296,680	8,296,680
09.08.2013	09.08.2018	7.70	7.84	ALTN5Y090818	2,100,000	2,100,000	63,494	2,163,494
13.06.2013	13.06.2020	9.12	9.32	ALTN7Y130620	2,000,000	2,000,000	8,994	2,008,994
14.09.2012	14.09.2019	10.40	10.66	ALTN7Y140919	7,100,000	7,100,000	216,968	7,316,968
18.06.2012	18.06.2019	10.85	11.14	ALTN7Y180619	9,500,000	9,500,000	34,232	9,534,232
20.09.2013	20.09.2020	7.38	7.51	ALTN7Y200920	1,500,000	1,499,933	30,791	1,530,724
20.09.2013	20.09.2020	7.38	7.51	ALTN7Y200920	2,000,000	2,000,000	40,893	2,040,893
16.12.2013	16.12.2020	7.45	7.58	AL0007NF7Y20	1,000,000	999,961	3,079	1,003,041
16.12.2013	16.12.2020	7.45	7.58	AL0007NF7Y20	1,500,000	1,500,000	4,513	1,504,513
29.10.2013	29.10.2023	9.25	9.46	AL001NF10Y23	2,800,000	2,800,000	44,021	2,844,021
					55,600,000	55,599,894	1,171,271	56,771,165

Fondi i Pensionit Vullnetar “SiCRED Pensions” - “SiCRED Pensions”

Voluntary Pension Fund

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare te mbyllura me 31 Dhjetor 2013

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

10. Investime në letra me vlerë (vazhdim)

Datë emetimi	Date maturimi	Interesi nominal (%)	Interesi efektiv (%)	Emërtimi	Vlera Nominale	Çmimi i blerjes	Interesa të përlogaritur	Vlera kontabël
20.08.2012	20.08.2014	8.40	8.58	ALTN2Y200814	1,400,000	1,400,000	42,467	1,442,467
09.02.2012	09.02.2017	9.50	9.71	ALTN5Y090217	8,000,000	8,000,000	297,667	8,297,667
18.06.2012	18.06.2019	10.85	11.14	ALTN7Y180619	9,500,000	9,500,000	34,358	9,534,358
14.09.2012	14.09.2019	10.4	10.66	ALTN7Y140919	7,100,000	7,100,000	217,418	7,317,418
05.10.2012	05.10.2015	8.84	9.03	ALTN3Y051015	2,000,000	2,000,000	41,744	2,041,744
05.10.2012	08.11.2017	9.17	9.37	ALTN5Y081117	2,400,000	2,400,000	31,789	2,431,789
20.12.2012	20.12.2014	7.68	7.84	ALTN2Y201214	1,600,000	1,600,000	3,413	1,603,413
					32,000,000	32,000,000	668,856	32,668,856

11. Detyrimi ndaj Shoqërisë Administruese

Detyrimi ndaj Shoqërisë Administruese prej Lek 144,094 (2012: Lek 79,514) paraqet nje tarifë administrimi e përlogaritur në bazë të Vlerës Neto të Aktiveve të Fondit, e cila ishte e papaguar në fund te vitit.

12. Të ardhura nga interesa të investimeve

	2013	2012
Të ardhura nga bono thesari	-	425,322
Të ardhura nga obligacione	4,099,104	1,560,818
Totali	4,099,104	1,986,140

13. Të ardhura të tjera nga interesa

	2013	2012
Të ardhura nga interesa të llogarisë rrjedhëse	-	808
Të ardhura nga interesa të depozitave	3,284	12,900
Total	3,284	13,708

14. Angazhime dhe detyrime të konstatuara

Ligjore

Në kursin normal të biznesit Shoqëria merr pretendime ligjore të cilat nuk i përkasin biznesit kryesor. Drejtimi i Shoqërisë ka opinionin që nuk do të ndodhin humbje materiale në lidhje me ndonjë pretendim ligjor deri më 31 Dhjetor 2013.

Fondi i Pensionit Vullnetar “SiCRED Pensions” - “SiCRED Pensions” Voluntary Pension Fund

Shenimet shpjeguese per pasqyrat financiare te mbyllura me 31 Dhjetor 2013

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

14. Angazhime dhe detyrime të konstatuara (vazhdim)

Detyrimet rastësore

Fondi ka trashëguar 600 anëtarë nga Instituti i Fondit të Pensionit i mëparshëm, të cilët janë punëmarrës të Kurum International sh.a bazuar në kontratën ndërmjet Institutit të Fondit të Pensionit “Garantsig” datë 16.06.2008. Nuk ka marrëveshje (kontratë) me secilin punonjës të Kurum International, që rrjedh nga kontrata kryesore e anëtarësisë së punëmarrësve në Institutin e mëparshëm.

Përveç kësaj, nuk ka marrëveshje ndërmjet Kurum International dhe Shoqërisë Administruese të Fondit të Pensionit SiCRED pas licensimit të kësaj të fundit sipas kërkesave të ligjit të ri. Për më tepër, nuk ka kontribute nga Kurum International për punëmarrësit që nga viti 2008. Shuma e aktiveve të akumuluar të Fondit për sa i takon Kurum International është 9,456,007 Lekë më 31 Dhjetor 2013 (2012: 9,456,007 Lekë). Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit njofton periodikisht Kurum International mbi statusin e aktiveve në fond për secilin punonjës, bazuar në një listë të punëmarrësve të siguruar nga Kurum International sh.a.. Bazuar në parashikimet e ligjit të ri për fondet e pensionit vetëm punëmarrësit të cilët kanë paguar në fond kanë të drejtë të tërheqin nga Fondi.

Në datën e nxjerrjes së pasqyrave financiare Shqëria Administruese e Fondit të Pensionit SiCRED sh.a. nuk është e vetëdijshme për ndonjë qëllim të punonjësve të Kurum International sh.a. për tërheqje të fondeve të tyre të akumuluar.

15. Transaksione me Palë të Lidhura

Palët konsiderohen të lidhura kur njëra ka aftësinë të kontrollojë apo të ushtrojë një influencë të konsiderueshme mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operacionale, apo palët janë nën kontroll të përbashkët me Fondin. Nje numër i caktuar transaksionesh me palë të lidhura janë ndërmarrë gjatë aktivitetit operacional. Këto transaksione janë kryer në përputhje me termat dhe normat e tregut. Volumi i këtyre transaksioneve dhe balancat në fund të periudhave respektive janë si më poshtë:

	2013	2012
<i>Vlera Neto e Aktiveve nga kontribute të punëdhënësit</i>		
<i>SiCRED Shoqëri Sigurimi Jete</i>	1,423,644	487,174
<i>KURUM International</i>	10,053,934	9,456,007

16. Ngjarje pas datës së raportimit

Drejtimi i shoqërisë nuk është në dijeni të ndonjë ngjarje pas datës së raportimit që do të kërkonte korigjime apo shënime sqaruese në pasqyrat financiare.

**Fondi i Pensionit Vullnetar “SiCRED Pensions” - “SiCRED Pensions”
Voluntary Pension Fund**

Skedule Suplementare të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31Dhjetor 2013

(të gjitha shumat në Lek, përvecse kur specifikohet ndryshe)

Skedule Suplementare

Fondi i Pensionit Vullnetar “SiCRED Pensions” - “SiCRED Pensions” Voluntary Pension Fund

Skedule Suplementare të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31Dhjetor 2013

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

Pasqyra e strukturës së investimeve

Përshkrimi	Shënime	31 Dhjetor 2013				31 Dhjetor 2012			
		Vlera nominale	Çmimi i blerjes	Vlera kontabël	% vs. Aktiveve të Fondit	Vlera nominale	Çmimi i blerjes	Vlera kontabël	% vs. Aktiveve të Fondit
Obligacione qeveritare	10	55,600,000	55,599,894	56,771,165	97%	32,000,000	32,000,000	32,668,856	93%
Depozita	9	-	-	-		2,040,000	2,040,000	2,040,364	6%
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	9	-	-	1,510,800	3%	-	-	238,150	1%
		55,600,000	55,599,894	58,281,965	100%	34,040,000	34,040,000	34,947,370	100%

Fondi i Pensionit Vullnetar “SiCRED Pensions” - “SiCRED Pensions”
Voluntary Pension Fund

Skedule Suplementare të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2012

(te gjitha shumat ne Lek, pervecse kur specifikohet ndryshe)

Pasqyra e ndryshimit të kuotave

	Numri i kuotave të pensionit	Vlera e Aktiveve Neto	Vlera e Aktiveve Neto për kuotë pensioni
Në fillim të periudhës	33,052	34,867,856	1,055
Emetuar gjatë periudhës	20,240	22,087,652	1,091
Tërheqje kuota në bazë të pagesave të pensionit dhe tërheqjeve të parakohshme	(1,456)	(1,565,007)	1,075
Në fund të periudhës	51,836	58,137,871	1,122